

Shenjat dhe simptomat

Meningjiti:

- ethe
- dhimbje shumë e rëndë koke
- të vjella
- qafë e ngrirë
- mospëlqimi i dritave të shndritshme
- skuqje
- konfuzion, marramendje e thellë
- përgjumje e rëndë, humbje e vetëdijes
- konvulsione/dridhje

Septikemia:

- ethe dhe dridhje
- të vjella
- dhimbje të forta dhe dhimbje në gjymtyrë dhe kyçe
- duart dhe këmbët shumë të ftohta
- lëkurë të zbehtë ose me lara
- frymëmarrje e shpejtë
- diarre dhe ngërçe në stomak
- Skuqje e kuqe ose vjollcë 'të mavijosur' ose me njolla që nuk zbehen nën presion - bëni testin e gotës të treguar sipër faqes. Në lëkurën e errët, kontrolloni brenda qepallave ose qiellzës së gojës ku njollat mund të jenë më të dukshme
- vështirësi në ecje ose qëndrimi në këmbë
- përgjumje e rëndë, humbje e vetëdijes

Jo të gjithë do t'i zhvillojnë të gjitha këto simptoma - ato mund të shfaqen në çdo mënyrë dhe të përzihen ndërmjet dy sëmundjeve. Është e rëndësishme të kërkonti këshilla mjekësore shumë herët nëse ju ose një mik keni simptoma shqetësuese ose një gjendje që po përkeqësohet me shpejtësi.

Sigurohuni që ju, familja dhe miqtë tuaj të kujdeseni për njëri-tjetrin dhe që dikush ta dijë nëse nuk jeni mirë, në mënyrë që të mund t'ju vëzhgojnë. Kjo mund të shpëtojë jetë!

Për më shumë informacion kontaktoni:

Meningitis Research Foundation (Fondacioni i Kërkimeve mbi Meningjitin)

Linja e ndihmës falas 0808 80 03 344

www.meningitis.org

Meningitis Now (Meningjiti tani)

Linja e ndihmës 24 orë

0808 80 10 388

www.meningitisnow.org

Lidhje interneti të dobishme:

- www.nhs.uk/conditions/meningitis
- www.nhs.uk/vaccinations
- www.nhs.uk/conditions/vaccinations/men-acwy-vaccine



UK Health
Security
Agency



© Crown copyright 2023
Product code IM23DISL1AL Albanian. 1P 30k AUG 2023 (APS).
UK Health Security Agency gateway number: 2023-360

Kjo fletëpalosje është në dispozicion në shkrimin Braille për personat e verbër, lexim të lehtë, tekst të thjeshtë, me audio, video BSL (gjuha e shenjave britanike) dhe e përkthyer në 28 gjuhë. Ju lutemi vizitoni www.healthpublications.gov.uk për të porositur kopjet tuaja sot ose telefononi 0300 123 1002




UK Health
Security
Agency



Meningjiti dhe septikemia

Mos i injoroni shenjat



i mmunisation
the safest way to protect your health

Jini të vetëdijshëm, përgatituni

Meningjiti meningokokal (inflamacion i membranave që rrethojnë trurin dhe shtyllën kurrizore) dhe septikemia (helmimi i gjakut) janë sëmundje të rralla, por të rënda që mund të vrasin ose lënë njerëzit me aftësi të kufizuara dhe probleme shëndetësore që ndryshojnë jetën. Si meningjiti ashtu edhe septikemia mund të çojnë në sepsis.

Adoleshentët, dhe studentët e universitetit në veçanti, janë në rrezik të shtuar. Por ju mund të mbron veten kundër katër llojeve të sëmundjes meningokokale duke marrë vaksinën tuaj falas MenACWY.

Mbroni veten me vaksinën MenACWY

Vaksina MenACWY do t'u ofrohet shumicës së adoleshentëve dhe të rinjve në Mbretërinë e Bashkuar të lindur nga shtatori 1996 kur janë në shkollë, por ata mbeten të kualifikuar deri në ditëlindjen e tyre 25^{vjeçare}. Studentët jashtë shtetit që hyjnë për herë të parë në një universitet në Mbretërinë e Bashkuar, të cilët nuk kanë bërë vaksinën MenACWY, kanë gjithashtu të drejtë deri në ditëlindjen e tyre 25^{vjeçare}. Nëse i përshtateni ndonjërit prej këtyre grupeve dhe nuk e keni bërë ende vaksinën, atëherë tani duhet të lini një takim me klinikën e mjekut tuaj të përgjithshëm. Nëse nuk jeni të sigurt, diskutoheni këtë me klinikën e mjekut tuaj të përgjithshëm.

Vaksina MenACWY është shumë efektive në parandalimin e meningjitit meningokokal dhe septicemisë të shkaktuar nga MenA, MenC, MenW dhe MenY.

Por mbani mend se kjo **vaksinë nuk mund të parandalojë të gjitha llojet e meningjitit dhe septicemisë**. Pra është shumë e rëndësishme që të jeni të vetëdijshëm për shenjat dhe simptomat.



Kontrolloni rregullisht këdo që nuk është mirë, mund të shpëtoni një jetë



Njihni shenjat dhe simptomat e meningjitit dhe septicemisë



Testi i gotës

Shtypni fort anën e një gote kundër skuqjes në mënyrë që të shihni nëse ajo zbehet nën presion apo jo. Nëse nuk zbehet, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore. Nëse ndiheni shumë të sëmurë, kërkoni ndihmë gjithsesi, edhe nëse skuqja zbehet ose nuk shfaqet fare.

Cilat janë shenjat dhe simptomat?

Shumë nga shenjat e hershme – të vjella, ethe, dhimbje, lodhje e përgjithshme dhe dhimbje koke – janë gjithashtu shenja të sëmundjeve më pak serioze si ftohja dhe gripi. Por dikush me meningjit ose septikemi zakonisht sëmuret rëndë brenda disa orësh.

Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme të vazhdoni të kontrolloni dikë që është i sëmurë, në mënyrë që të dini nëse ai/ajo po përkeqësohet me shpejtësi dhe të vazhdoni të kërkoni për shenja dhe simptoma. Kërkoni urgjentisht ndihmë mjekësore nëse shqetësoheni për shëndetin tuaj ose të tyre.

Është gjithashtu e rëndësishme të shikoni për duar dhe këmbë të ftohta, dhimbje të forta gjymtyrësh dhe lëkurë të zbehtë dhe me njolla, pasi këto priren të zhvillohen në fillim të sëmundjes. Simptomat të tilla si skuqja që nuk zbehet (bëni testin e gotës prej xhami të treguar përballë), të qenit konfuz ose maramendje të thellë, ose shumë i përgjumur për t'u zgjuar janë shumë të rëndësishme.

Si përhapet meningjiti?

Bakteret që shkaktojnë këto sëmundje zakonisht përhapen nga kontakti i afërt ose i gjatë. Shumica e rasteve ndodhin individualisht, por shpërthimet ndonjëherë ndodhin në shkolla ose ku njerëzit ndajnë hapësirën e jetesës, siç janë konviktet e universitetit.

Bëni vaksinën e MenACWY në klinikën tuaj të mjekut të përgjithshëm. Në disa zona, mund të jetë në dispozicion në farmacinë tuaj.